



Menaxhimi i Projekteve

LIGJERUES: BUTRINT **BATALLI**

Menaxhimi i Projekteve

Përmbajtja

Menaxhimi i Projekteve;

II

- ▶ Procesi i menaxhimit strategjik të projektit;
- ▶ Fazat e projektit dhe ciklit të jetës;
- ▶ Llojet e menaxhimit të projekteve, 5-Fazat e menaxhimit të projektit.
- ▶ Përzgjedhja e ideve; Identifikimi i projekteve; Analiza para-investive;
- ▶ Vlerësimi i varianteve për zgjedhjen e projekteve;



Menaxhimi i Projekteve;

Procesi i menaxhimit strategjik të projektit;

Fazat e projektit dhe ciklit të jetës;

5-Fazat e menaxhimit të projektit.

Përzgjedhja e ideve; Identifikimi i projekteve;

Parakushtet e suksesit të projekteve;

Cfarë është Projekti

Një set unik i aktiviteteve të koordinuara, me afat të definuar të fillimit dhe mbarimit, të ndërmarra nga një individ ose organizatë për të përmbushur objektivat specifike brenda orarit të përcaktuar, koston dhe parametrave të performancës.



Procesi i menaxhimit strategjik të projektit

- ▶ Menaxhimi strategjik I projektit është process I vlerësimit se “cfare jemi ne” i marrjes së vendimit dhe implementimit “se cfarë synojmë të jemi dhe si do të arrijmë”.
- ▶ Strategjia përshkruan se si një ndërmarrje synon të konkuroj me burimet në dispozicion tani dhe në të ardhmen.



Aktivitetet e procesit te menaxhimit strategjik

Katër Aktivitetet e Procesit të Menaxhimit Strategjik

Sekuensa tipik e aktiviteve të procesit të menaxhimit strategjik dhe një përshkrim të çdo aktiviteti është si vjon:

1. Rishikimi dhe përcaktimi i misionit të ndërmarrjes.
2. Vendosja e qëllimeve dhe objektivave afatgjata.
3. Analiza dhe formulimi i strategjisë për të arritur objektivat.
4. Zbatimi i strategjive përmes projekteve.



Fazat e projektit dhe ciklit të jetës

- Projektet dhe menaxhimi i projekteve performohen në një mjedis më të gjerë se ajo e vetë projektit. Ekipi menaxhues i projektit duhet të kuptojnë këtë kontekst më të gjerë në mënyrë që të mund të zgjedh fazat e ciklit të jetës, proceset dhe mjetet dhe teknikat që përshtaten në mënyrë adekuate projektit.

Menaxherët e projektit apo organizatës mund të ndajnë projektet në faza për të siguruar menaxhim më të mirë dhe lidhje të përshtatshme për operacionet rutinore të organizatës. Kolektivisht, këto faza janë të njohur si cikli i jetës së projektit.

Cikli i jetës i projektit përcakton fazat që lidhin fillimin e një projekti për fundin e tij.

Cikli i jetës së projektit

Ciklet e jetës të projektit përgjithësisht përcaktojnë:

- ❑ Çfarë pune teknik të bëhet në çdo fazë (për shembull, në cilën fazë duhet të kryhet puna e arkitektit?)
- ❑ Kur gjenerohen rezultatet në çdo fazë dhe si rishikohet, verifikohet dhe vërtetohet çdo rezultat/output.
- ❑ Kush është i përfshirë në çdo fazë (për shembull, inxhinieri kërkon që zbatuesit të përfshihen me kërkesat dhe dizajn)
- ❑ Si të kontrollohet dhe të miratohet çdo fazë.



Cikli i jetës së projektit

Fazat e një projekti përbëjnë ciklin e jetës të projektit.

Është i përshtatshëm për menaxherët e projektit për të ndarë projektin në faza për qëllime të kontrollit dhe përcjelljes së aktiviteteve.

Çdo objektive në çdo fazë është elaboruar më pas dhe gjurmuar për përfundimin me sukses.

Fazat themelore të një projekti janë të varur nga lloji i projektit që është duke u kryer.




Cikli i jetës së projektit



Një projekt tipik është i ndarë në disa faza. Secila fazë e projektit ka rëndësinë e vet dhe ndikon në suksesin e përgjithshëm të projektit.

Në vijim janë fazat që përbëjnë një projekt tipik:


Fazat e ciklit të jetës së projektit



FAZA E INICIMIT:

- Përzgjedhja e projektit
- Në këtë fazë të projektit, reagime të marra nga konsumatorët analizohen dhe merren vendime për të zhvilluar produkt të ri ose të modifikuar produktin ekzistues për të përmbushur kërkesat e reja


Fazat e ciklit të jetës së projektit



FAZA E PLANIFIKIMIT:

- Identifikimi i të gjitha punëve që duhet të realizohen, aspekti kohor, buxhetimi, dhe shumë më tepër.
- Në këtë fazë, planifikimi i projektit është bërë dhe janë caktuar rezultatet e pritshme.


Fazat e ciklit të jetës së projektit



FAZA E EKZEKUTIMIT:

- Të bësh punën, realizimi i aktiviteteve-ndërtimi i produkti.
- Në këtë fazë të gjitha aktivitetet dhe objektivat e vendosura në fazë fillestare janë ekzekutuar në kohën dhe mënyrën e duhur.
- Kjo fazë përdor maksimumin e të gjitha burimeve.


Fazat e ciklit të jetës së projektit



FAZA E MONITORIMIT & KONTROLLIT:

- Monitorimi i realizimit të aktiviteteve të planifikuara.
- Vlerësimi mbi statusin e projektit.
- Raportimi mbi statusin e projektit.

Fazat e ciklit të jetës së projektit



FAZA E MBYLLJES:

- Mbyllja e aktiviteteve dhe dorëzimi i projektit.
- Kjo është faza e fundit e projektit. Në këtë fazë, produkt ose shërbim final është dorëzuar tek ekipi i operacioneve për prodhim komercial.

Cikli i jetës së projektit

Ciklet e jetës të projektit përgjithësisht përcaktojnë:

- ❑ Çfarë pune teknik të bëhet në çdo fazë (për shembull, në cilën fazë duhet të kryhet puna e arkitektit?)
- ❑ Kur gjenerohen rezultatet në çdo fazë dhe si rishikohet, verifikohet dhe vërtetohet çdo rezultat/output.
- ❑ Kush është i përfshirë në çdo fazë (për shembull, inxhinieri kërkon që zbatuesit të përfshihen me kërkesat dhe dizajn)
- ❑ Si të kontrollohet dhe të miratohet çdo fazë.



Përzgjedhja e projekteve

Vlerësimi i opsioneve për përzgjedhjen e projekteve

Metoda e vlerësimit të projektit	Përshkrimi	Kur kjo metodë është e përshtatshme
Analiza financiare	Projektet ose variantet e projektit krahasohen duke u bazuar në tregues të tillë si periudha e shlyerjes, vlera neto prezente, norma e brendshme financiare duhet të krahasohet nga pikëpamja e rëndësisë me vlerësimet e riskut për çdo projekt	<ul style="list-style-type: none">• E përshtatshme kur është në dispozicion informacion i mjaftueshëm dhe i besueshëm mbi kostot e projektit dhe përfitimet financiare për të argumentuar analizat.• E vlefshme kur projekti përfshin një buxhet relativisht të madh dhe kur rezultatet financiare janë të rëndësishme për të marrë vendimin për zgjedhjen.• Nuk duhet të përbëjnë të vetmin mekanizëm të vlerësimit paraprak, pasi është e nevojshme që të konsiderohen dhe kriteret tjera jo financiare.

Përzgjedhja e projekteve

vazhdim

Vlerësimi i opsioneve për përzgjedhjen e projekteve

Metoda e vlerësimit të projektit	Përshkrimi	Kur kjo metodë është e përshtatshme
Listimi i avantazheve dhe disavantazheve	Vlerësimi në këtë rast është mjaft subjektiv duke bërë përzgjedhjen e atyre projekteve që ofrojnë avantazhe më të rëndësishme dhe më pak disavantazhe.	<ul style="list-style-type: none">E përshtatshme si mënyrë vlerësimi kur projekti është i vogël dhe nuk kërkohen analiza financiare apo analiza të tjera komplekse.

Përzgjedhja e projekteve

vazhdim

Vlerësimi i opsioneve për përzgjedhjen e projekteve

Metoda e vlerësimit të projektit	Përshkrimi	Kur kjo metodë është e përshtatshme
Renditja e faktorëve	Grupi apo politika e organizatës paracakton një paketë kriteresh për vlerësimin e projekteve, në të cilën mund të përfshihet performanca financiare që pritet. Çdo kriter vlerësohet mbi masën e rëndësisë përkatëse dhe pjesëmarrësit i rendisin projektet konkurruese ose opsionet e projektit dhe pikët totale llogariten për secilin duke u bazuar në vlerësimin e ponderuar.	<ul style="list-style-type: none">• E përshtatshme kur kriteret e zgjedhjes janë domosdoshmërisht shumë më të gjerë se sa vetëm rezultatet financiare.• E vlefshme kur anëtarët e grupit nuk kanë konsensusin që në fillim për kriteret e zgjedhjes.• E përshtatshme kur inputi i grupit është i rëndësishëm për suksesin e projektit apo zgjedhjen e opsionit.• Shton një element të vlerësimit sasior që u demonstron anëtarëve të grupit.

Përzgjedhja e projekteve

vazhdim

Vlerësimi i opsioneve për përzgjedhjen e projekteve

Metoda e vlerësimit të projektit	Përshkrimi	Kur kjo metodë është e përshtatshme
Analiza SWOT	Bëhet një vlerësim i anëve të forta, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve që lidhen me projektin apo opsionet e tij.	<ul style="list-style-type: none">• Veçanërisht e vlefshme kur projektet apo opsionet janë subjekt i forcave pozitive apo negative brenda organizatës (anëve të forta dhe dobësive) dhe jashtë organizatës.• Mund të funksionojë më mirë si metodë kur projektet e mundshme janë duke u vlerësuar gjatë planifikimit strategjik.

Përzgjedhja e projekteve

vazhdim

Vlerësimi i opsioneve për përzgjedhjen e projekteve

Metoda e vlerësimit të projektit	Përshkrimi	Kur kjo metodë është e përshtatshme
Indeksi i Prioritetit Pareto (IPP)	Një individ ose grup grumbullon informacion mbi koston e projektit apo opsioneve të projektit si dhe mbi kursimet e parashikuara në kosto. Grupi përdor konsensusin ose votimin për të vlerësuar probabilitetin e suksesit të projektit. Renditja e projekteve më pas bëhet sipas IPP.	<ul style="list-style-type: none">• E përshtatshme për projektet në të cilat kursimet e koston mund të parashikohen si rezultate të projektit (kryesisht projektet e përmirësimit të procesit janë shembuj)• Aspekti kuantitativ ofron sensin e objektivitetit.

Tabela 2.1: Metodatat për vlerësimin e projekteve dhe opsioneve të projektit, Burimi: Suzana Panariti: Manaxhimi i Projekteve, 2013



Përgatiti: Butrint BATALLI

Email: butrint@inovaconsulting.eu